



## Informacion për prindërit. Reformimi i nivelit 3 të shkallës sekondare (3.Sek)

### **Hyrje optimale në jetën profesionale dhe në shkollat me kualifikim të mëtejshëm**

#### **Situata „Win-win“**

Një investim në të ardhmen e arsimit: Nxënëset dhe nxënësit e nivelit 3 në shkallën sekondare në kantonin e Cyrihut parapërgatiten enkas në lidhje me kërkesat e shkollimit profesional apo të një shkolle me kualifikim të mëtejshëm.

Synimi është të arrihet një situatë „Win-win“ ndërmjet shkollës sekondare nga njëra anë dhe të ndërmarrjeve kualifikuese apo shkollave të mesme dhe atyre profesionale nga ana tjetër.

Lidhja Industriale dhe Artizanale në kantonin e Cyrihut (KGV), organizatë mbi KMU-në në kantonin e Cyrihut, i përkrah ndryshimet në shkallën sekondare.

#### **Qëllimet e riorganizimit**

- Bashkëpunim i hershëm dhe i ngushtë mes shkollave, këshillimit profesional dhe prindërve në procesin e zgjedhjes së profesionit.
- Orientim individual mbi bazën e „Testit konstatues 8“ në nivelin 2 të shkallës sekondare krahas takimit mësues-prindër me subjekt vlerësimin dhe arritjen e qëllimit
- Mundësi të mbështetjes individuale në lëndën përzgjedhëse të nivelit 3 të shkallës sekondare, me qëllim të mësuarit dhe nxitjen optimale në bazë të rezultateve.
- Punë në dobi të mbylljes së boshllëqeve, përforcim i prirjeve në shkollë
- Përforcim i kompetencave vetjake, shoqërore si dhe metodike me anë të mësimin në formë projekti dhe provimit përmblyës në nivelin 3 (3.Sek) të shkallës sekondare.
- Përgatitje për kalimin e suksesshëm në arsimin bazë profesional dhe provimet pranuese në gjimnazin me kohëzgjatje të shkurtë dhe shkollën e mesme profesionale.

#### **Marrje përgjegjësie**

- Në mes të nivelit 2 në sekondare testimi i standardizuar i përpjekjeve në shkollë „Kulla drejtuese 8“(Stellwerk 8) paraqet në mënyrë të besueshme gjendjen mësimore të nxënësve dhe nxënësve në një profil përpjekjesh individuale, dhe të pavarur nga tipi i shkollës.

- „Kulla drejtuese 8“ (Stellwerk 8) është një sistem testimi i adaptuar kompjuterik, që sjell një orientim për lëndët gjermanisht, frëngjisht, anglisht, matematikë, dukuri natyre dhe teknikë.
- Kulla drejtuese lë të kuptohet si një sistem testimi me synim nxitës, që i tregon nxënëset dhe nxënësit në një profil përpjekjesh, ku janë forcat dhe dobësitë e tyre. Profili i përpjekjeve dhe një tabelë analizuese ndihmojnë, për të marrë masat e duhura për një nxitje efikase. .
- Gjatë një takimi në shkollë arrihen bashkë me prindërit, nxënëset dhe nxënësit qëllime dhe çështje të obligueshme.
- Ofrimi i mësimi individual i nxit nxënëset dhe nxënësit në nivelin 3 të sekondares, të zhvillojnë më tej përparësitë dhe të mbyllin boshllëqet që bien në sy.
- Një mbështetje enkas u jepet edhe nxënëseve dhe nxënësve me arritje të mira, të cilët planifikojnë kalimin në gjimnazin me kohëzgjatje të shkurtër apo në shkollën e mesme profesionale.
- Vëmendje të veçantë në nivelin 3 të shkallës sekondare u kushtohet edhe asaj, që nxënëset dhe nxënësit të mësojnë të jenë të vetëpërgjegjshëm për përparimin e tyre në profesion dhe jetë.

Projekti „Reformimi i nivelit 3 të shkallës sekondare“ «Neugestaltung 3. Sek» është testuar me sukses në shkolla pilot të ndryshme dhe do të futet në etapa që nga viti shkollor 2009/10 – duke filluar me klasat e 1-ra të shkallës sekondare.

Që prej verës 2012 nxënëset dhe nxënësit e parë do të kenë kryer nivelin e 3-të të shkallës sekondare.

Më tepër mbi reformimin gjeni në [www.vsa.zh.ch](http://www.vsa.zh.ch)